

RELACION

PËR

PROJEKT LIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9270, DATË 29.7.2004, “PËR SISTEMIN E ADRESAVE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit është miratimi i ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar”, në zgjidhje të problematikave të krijuara nga mosangazhimi i strukturave përkatëse në respektim të detyrimeve ligjore në proceset e emërtimit dhe të numërtimit të pjesëve të territorit publik.

Ky proces përbën gjithashtu një nga ceshtjet prioritare në kuadër të nismës së ndërmarrë në Komitetin e Inovacionit, të mbajtur më datë 15.07.2022, për krijimin e një kodi unik si përfaqësues unik i adresës deri në rang ndërtese.

Adresimi i pjesëve të territorit publik është një proces shumë i domosdoshëm për menaxhimin urban dhe për orientimin e shtetasve në zonën që ata vetë banojnë, apo dhe kur vizitojnë, qarkullojnë në zona të tjera.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projekt-akteve të Këshillit të Ministrave, për vitin 2023.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji synon zgjidhjen e problematikave të krijuara deri më tani për sistemin e adresave në territorin e Republikës së Shqipërisë, që kryesisht derivojnë nga mosndjekja e procesit të emërimit nga njësitë bazë të qeverisjes vendore, bashkitë, si dhe në vijim të porosisë së Kryeministrit, nëpërmjet së cilës është përcjellë aplikimi i sanksioneve të forta ndaj bashkive që nuk përmbushin këtë proces, i parashikuar për t'u përmbyllur që në vitin 2016.

Përmbushja e kësaj detyre është sanksionuar në dispozitat sipas pikës 2 të nenit 29 të ligjit aktual, ku shprehimisht parashikohet se: "*Seksionet/zyrat e urbanistikës në njësitë e vetëqeverisjes vendore/njësitë administrative duhet të bëjnë adresim numerik të brendshëm e të jashtëm të objekteve ekzistuese, brenda datës 31 dhjetor 2016*", miratuar me ligjin nr.89/2016, datë 15.09.2016 dhe që nuk është përmbushur deri më tani.

Procesi i emërimit të pjesëve të territorit publik i vjen në ndihmë shtetasve të lokalizojnë një ndërtesë/apartament, një rrugë, një shesh, një park, një biznes, një zyrë shërbimi, etj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky projekt ligj propozohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligji nuk përfron asnjë *acquis*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 14 nene.

Në nenin 1 të projektligjit parashikohet zëvendësimi i terminologjisë ekzistuese të përdorur, duke i atribuar drejtpërdrejt procesin adresimit të pjesëve të territorit publik bashkive, si njësia bazë e vetëqeverisjes vendore. Ky përcaktim më i saktë bëhet referuar ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i cili rregullon funksionimin e organeve vendore në Republikën e Shqipërisë, sipas funksioneve, kompetencave, të drejtave dhe detyrave të tyre, të cilat veprojnë në bazë të parimit të autonomisë. Sipas nenit 1, pika 3 e projektligjit ky zëvendësim aplikohet në tërësi të përmbajtjes së ligjit.

Sipas kuptimit në nenin 5 të këtij ligji vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë realizohet nga bashkitë dhe qarqet, dispozitë në të cilën specifikohet se njësia bazë e vetëqeverisjes vendore është bashkia.

Realizimi i procesit të adresimit të pjesëve të territorit publik, duhet t'i atribuohet drejtpërdrejt kësaj njësie të vetëqeverisjes vendore, e cila në kuptim të nenit 23 të ligjit është përgjegjëse në territorin e saj juridiksional për manaxhimin e funksioneve kryesore që lidhen me furnizimin me ujë të pijshëm, mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimin rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore, një pjesë e të cilave deri më tani janë të paemërtuara.

Procesi i emërimit të pjesëve të territorit publik në vëmendje të qeverisë qendrore, që kërkohet të realizohet në bazë të ndryshimeve të propozuara, pikë së pari i shërben vetë organeve vendore për përmbushjen e kompetencave të tyre të dhëna me ligj për planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit.

Sipas dispozitës së riformuluar që në pjesën hyrëse të ligjit ku përcaktohet qëllimi i tij shtohen gjithashtu fjalët "Regjistri Kombëtar i Adresave" (RKA), si baza e të dhënave gjatë përditësimit të së cilës do të kryhen të gjitha pasqyrimet e nevojshme për proceset kryesore të emërimit dhe numërimit, ku bazohet mirëfunksioni i sistemit të adresave.

Në nenin 2 të projektligjit, ku gjithashtu bëhet emërtimi "Përkufizime", i nenit 1/1 të ligjit, janë bërë plotësimet që i korrespondojnë kuptimit të fjalës adresë, si një seri informacioni e standardizuar. Sipas dispozitës që propozohet për kuptimin e adresës është hequr gjithashtu dhe togfjalëshi ekzistues "shenja ortografike". Adresa nuk mund të përbëhet nga shenja ortografike, por vetëm nga fjalë dhe numra të renditura sipas një rregulli të përcaktuar.

Referuar dhe legjislacionit të aplikueshëm nga vende të tjera, shenjat ortografike nuk mund të përbëjnë adresën e një pjese të territorit publik.

Sipas formulimit në pikën 2 të nenit 1, për pjesët e territorit publik "bulevardi", "ruga", "rrugica", "sheshi" dhe "parku", shtohen dhe fjalët "zonë e qarkullimit civil", përkufizim që i shërben më së miri kuptimit të legjislacionit për adresat duke nënkuptuar se këto pjesë të territorit publik janë të hapura për publikun dhe të destinuara për lëvizshmëri.

Sipas formulimit të propozuar për pikën 4 të nenit 1/1 të ligjit jepet një përcaktim më adekuat për Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA), si baza e vetme e të dhënave shtetërore, në të cilën regjistrohen dhe përditësohen të dhënat për adresën sipas elementëve të saj për çdo ndërtesë, apartament dhe truall të lirë.

Gjithashtu kjo dispozitë, ku prezantohen konceptet e përdorura në kuptim të këtij ligji, pasurohet me pikat 5, 6, 7 dhe 8 që në mënyrë specifike i referohen "tabelës së emërimit", "tabelës së numërimit", "kodit unik" dhe Pikave të Interesit (PI). Gjithashtu Pikat e Interesit (PI) në kuptim të këtij ligji përbëjnë një adresë me interes në ofrimin e shërbimeve bazë publike për shtetasit, siç janë ato arsimore, të shëndetësisë, kulturore, të transportit, të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, të rendit, turistike, etj.

Sipas nenit 3 të projektligjit gjithashtu bëhet emërtimi i dispozitës së paemërtuar ekzistuese të ligjit që i referohet elementëve të adresës. Në pikën 1 të nenit 2, pas fjalës "vendndodhjen" shtohet gjithashtu fjala "në terren", në mënyrë që të kemi një mirëpërcaktim të adresës së standardizuar dhe qëllimit se për çfarë shërben.

Në shkronjën d) të pikës 1 hiqen fjalët "bulevardit/rrugës/rrugicës/parkut ose sheshit, pasi me numra rendorë në kuptim të këtij ligji renditen vetëm ndërtesat dhe jo pjesët e tjera të territorit publik, që janë "bulevardi", "ruga", "rrugica" ose "sheshi".

Për sa i përket “kodit unik”, si një element i ri i prezantuar pas pikës 2 të nenit 3 shtohet pika 3, në bazë të së cilës përcaktohet se *“Algoritmi dhe struktura e kodit unik të adresës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”*. Ky propozim përkon në vijim të porosisë së dhënë në takimin e Komitetit të Novacionit, të mbledhur më datë 15.07.2022, nga kryetari i këtij komiteti, ku gjithashtu është propozuar se përshkrimet e detajuara teknike për mënyrën e krijimit të tij, algoritmi dhe struktura e kodit unik të adresës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky përkuzimin formulohet edhe në përputhje me përcaktimin e bërë në fjalorin e gjuhës shqipe, ku përcaktohet se: *“Kod- Sistem shenjash a sinjalesh konvencionale dhe “Unik - që është vetëm një, që s’ka tjetër të ngjashëm me të...”*.

Gjithashtu, sa i takon kodit unik, në urdhrin nr. 208, datë 27.12.2022 të Kryeministrit *“Për krijimin e grupit ndërinstytucional të punës për përmirësimin e sistemit kombëtar të adresave dhe ndërlidhjen e Regjistrit Kombëtar të Adresave me bazat e të dhënave shtetërore”* është parashikuar si një ndër përgjegjësitë kryesore dhe detyrë e grupit të punës, si vijon: *“Bashkërendon punën për përcaktimin e metodologjisë për mënyrën e kodimit (algoritmit) dhe strukturës së kodit unik të adresës.”*

Në nenin 4 të projektligjit, është parashikuar emërtimi i dispozitës ekzistuese *“Krijimi dhe administrimi i RKA-së”*, dispozitë në të cilën shfuqizohen pikat 1 dhe 3 lidhur përditësimin dhe administrimin e regjistrit vendor të adresave, të cilët me ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Kombëtar të Adresave (RKA) nuk funksionojnë. Çdo veprim përditësimi nga zyrat e urbanistikës në bashki, si strukturat përgjegjëse për planifikimin e territorit kryhet në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA).

Në të njëjtën mënyrë shfuqizohet dhe dispozita sipas nenit 3 të ligjit që i përket mënyrës së krijimit, administrimit të regjistrave vendorë dhe Regjistrit Kombëtar të Adresave, si dhe rregullave të shfrytëzimit të sistemit e të rrjetit informatik.

Pas nenit 4/1, *“Krijimi dhe administrimi i RKA-së”*, shtohet neni 4/2, dispozitë në të cilën specifikohen të dhënat parësore dhe dytësore të Regjistrit Kombëtar të Adresave (RKA), ku si të dhëna parësore renditen: elementët përbërës të adresës, gjurma gjeohapësinore, kodi unik dhe koordinatat gjeografike gjatësi dhe gjerësi dhe ortofo si e dhënë dytësore.

Siç e përmendëm, krahas kodit unik, në takimet e zhvilluara nga ekspertë, i referohemi këtu Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe të Koordinimit të Ndihmës, është propozuar konkretisht ku si të dhëna parësore të RKA-së krahas elementeve përbërës të adresës të përbërë nga emri i bashkisë ku ndodhet ndërtesa, emri i njësisë administrative ku ndodhet ndërtesa, emri i bulevardit/rrugës/rrugicës/sheshit ose parkut ku ka daljen ndërtesa dhe përcaktohet vetëm me njërin nga elementët e mësipërm, numri rendor i ndërtesës, numri i hyrjes që shërben për identifikimin e hyrjes në të njëjtën ndërtesë, numri i apartamentit dhe kodi postar.

Elementë përbërës i adresës sipas kësaj dispozite është dhe gjurma gjeohapësinore, ku përfshihen kufinj të administrativë të bashkisë, kufinj të administrativë të njësisë administrative, kufinj të administrativë të qytet/fshatrave, segmentet rrugore, gjurmët e ndërtesave, gjurmët e hyrjeve dhe koordinatat gjeografike gjatësi dhe gjerësi për çdo gjurmë, të cilat përkojnë me koordinatat X dhe Y të numrit të hyrjes në ndërtesë, në sistemin gjeoreferencial, si të dhëna

parësore dhe kodi unik. Kufijtë administrativë përcaktohen në bazë të ligjit nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrative territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*. Procesi i numërimit realizohet për: numërimin e ndërtesës, të hyrjeve dhe apartamenteve në brendësi të saj.

Si e dhënë dytësore në përmbajtje të kësaj dispozite cilësohet ortofoto, i cili përbën imazhin fotografik të terrenit, projekcioni qendror i të cilit është shndërruar në një projekcion ortogonal.

Në pikën 2 të nenit 4/2 të ligjit është shtuar formulimi që i përket Pikave të Interesit, si një informacion i cili gjendet në RKA, të cilat përbëjnë lokacione specifike që çdokush mund t'i gjejë të përdorshme ose interesante në territorin e bashkisë si njësi bazë e vetëqeverisjes.

Sipas pikës 3 të nenit 4/1, përcaktohet gjithashtu se struktura përgjegjëse për planifikimin e territorit në bashki përditëson (Regjistrin Kombëtar të Adresave) RKA-në, pra është kjo strukturë ndeshur në më të shumtën e rasteve sipas emërimit *“zyrat e urbanistikës”*, të cilat në përmbajtje të projektligjit zëvendësohen me togfjalëshin *“struktura përgjegjëse për planifikimin e territorit”*, duke i dhënë një kuptim sipas funksionit të mirëfilltë që ato kryejnë.

Pika 4 në nenin 4/2 të projektligjit parashikon se RKA aksesohet lirisht nga çdo person, në faqen zyrtare të RKA-së, duke specifikuar disponueshmërinë e këtij regjistri nga të gjitha subjektet e interesuar në respektim të së drejtës së informimit.

Sipas nenit 4/3 rregullohet vënia në dispozicion e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Adresave (RKA-së), ndaj subjekteve të interesuar me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile. Gjithashtu kjo dispozitë parashikon se tarifata për ofrimin e të dhënave të RKA-së miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Subjekte të interesuar, siç janë edhe kompanitë ndërkombëtare Tom Tom, Atom, etj, kanë shprehur interes për të marrë të dhënat që disponon RKA.

Sipas nenit 5 dhe nenit 6 të projektligjit në kuadër të respektimit të rregullave të teknikës legislative në titullin e Kreut II (Kriteret për emërimin e adresës) dhe Kreut III (Rregullat për numërimin e adresës) hiqet fjala *“adresës”*, nga këto tituj.

Për nenin 7 të projektligjit, referuar pikëpamjeve të ndara në opinione të ekspertëve për zbatimin e Konventës Kuadër për Minoritetet Kombëtare është sugjeruar që emërimi i pjesëve të territorit të publik nga bashkitë të bëhet dhe në gjuhën e pakicës. Përmendim këtu ceshtjet e trajtuara në opinionin e 5-të për Shqipërinë të Komitetit Këshillues për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, të miratuar më datë 06.06.2023, *Të drejtat e gjuhës, pika 10*, ku shprehimisht specifikohet se: *“Komiteti Këshillues është në favor të një përqasje më të diferencuar, e cila duhet t'i sigurojë akses të drejtave të minoriteteve në një nivel më të ulët lokal se ai i bashkisë (ku përmendet se kjo gjithashtu mund të arrihet për shenjat e rrugëve), në fshatrat ku jetojnë minoritetet kombëtare”*.

Për këtë arsye drejtpërdrejt në projektligj sipas nenit 7 të tij u bënë parashikimet përkatëse. Në analizë më të thelluar gjithashtu ky parashikim gjendet në përmbajtje të vendimit nr. 446, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e specifikimeve teknike të tabelave të emërtimeve të parqeve, shesheve, bulevardeve e rrugëve dhe të numërtimeve të ndërtesave”*, për sa konstatohet se mungon adresimi, autorizimi ligjor.

Sipas Aneksit I., seksioni II, shkronja c), të këtij akti nënligjor parashikohet shprehimisht se: *“Në njësitë e qeverisjes vendore, ku banojnë minoritete kombëtare dhe kur ka kërkesë, tabelat do të shkruhen në dy gjuhë, duke iu përmbajtur specifikimeve teknike të tabelave dhe duke ruajtur të njëjtën madhësi shkronje për të dyja gjuhët”.*

Në nenin 8 të projektligjit parashikohet shtimi i neneve 25/1, 25/2 dhe 25/3 pas nenit 25 të ligjit. Sipas nenit 25/1, të propozuar parashikohet emërtimi i pjesëve të territorit publik si një proces në të cilin përcaktohen organet përgjegjëse për ndjekjen e tij, sikurse bashkia e cila ka detyrimin për vendosjen e tabelave të emërtimit sipas adresës në RKA, duke evidentuar si një domosdoshmëri parashikimin e afatit të propozuar prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga miratimi i projektligjit.

Ndërkohë, strukturës përgjegjëse për planifikimin e territorit në bashki i është caktuar detyra konkrete që ka të bëjë me indentifikimin e zonave të qarkullimit civil të paemëtuara.

Me qëllim kontrollin e këtij procesi të emërtimit është parashikuar raportimi i ecurisë së tij nga bashkia përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), në varësi të Ministrisë së Brendshme, propozuese e këtij akti. Në këtë mënyrë synohet të realizohet dhe procesi i kontrollit të drejtpërdrejtë në RKA, krahas verifikimit në terren nga bashkia, si njësisia bazë e vetëqeverisjes vendore, e ngarkuar drejtpërdrejt me zbatimin e këtij ligji.

Në këtë mënyrë synohet gjithashtu integrimi për mbarëbajtjen e këtij procesi nëpërmjet kontrollit fizik në terren nga bashkia dhe atij virtual në RKA që do të mundësohet paralelisht dhe në mënyrë periodike nga strukturat përkatëse në DPGJC. DPGJC angazhohet të ndjekë këtë proces në bazë të filtrimit të të dhënave përbërëse të RKA-së që do të rezultojnë për t'i dhënë shtysë të mëtejshme dhe referim pranë bashkive që të realizojnë dhe përfundojnë me sukses këtë proces sipas afateve ligjore. Në të kundërt, për mosrespektimin e rregullave janë parashikuar sanksione.

Në nenin 25/2 të ligjit parashikohet procesi i numërtimit nëpërmjet kontrollit të mbarëvajtjes së procesit të vendosjes së tabelave të numërtimit fizik të ndërtesave, të hyrjeve dhe apartamenteve nga bashkia. Krahas aspektit të jashtëm që ka të bëjë me emërtimin e pjesëve të territorit publik, bashkia njëkohësisht është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit të adresimit të brendshëm numerik që ka të bëjë me numërtimin e ndërtesave, hyrjeve dhe apartamenteve nën juridiksionin e saj.

Në dallim nga procesi i emërtimit në të cilin bashkia vendos tabelat e emërtimit për zonën e qarkullimit civil në procesin e numërtimit risia qëndron në parashikimin në vendosjen e tabelave të numërtimit nga pronari i ndërtesës. Sa i takon afatit për realizimin, përmbushjen e këtij procesi theksojmë se ai mbetet i njëjtë sikurse afati i parashikuar për procesin e emërtimit, përkatësisht 90 (nëntëdhjetë) ditë. Ky afat përlllogaritet i ndryshëm nga ai i aplikuar në procesin e emërtimit. Llogaritja e tij do të fillojë nga miratimi i rregullave të për vendosjen e tabelës së numërtimit përmes një akti nënligjor.

Detyra e strukturës përgjegjëse për planifikimin e terriotrit në bashki dhe detyrat e bashkisë për të raportuar në DPGJC mbeten të njëjta, si në rastin e procesit të emërtimit.

Dispozita sipas nenit 25/3, parashikon aplikimin e sanksioneve administrative për procesin e emërtimit dhe numërtimit, me qëllim arritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të rezultateve të pritura për procesin e adresarit, të cilat deri më tani sipas legjislacionit aktual nuk kanë gjetur zbatim në praktikë, duke lënë pjesë të territorit publik të paemërtuara, si problematika që njëkohësisht bëhen pengesë jo vetëm për popullsinë vendase, por dhe për shtetasit e huaj numri i të cilëve është shumëfishuar nga zhvillimi i një prej sektorëve kryesorë të ekonomisë, atij të turizmit.

Masa administrative e parashikuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile ndaj bashkisë në të cilën do të rezultojnë pjesë të territorit publik të paemërtuara dhe të panumërtuara me tabelat përkatëse, propozohet të jetë 100 000 (njëqind mijë) lekë, si sanksion i cili përbën titull ekzekutiv dhe theksojmë se do të zbatohet për çdo pjesë të territorit publik që do të rezultojë e paemërtuar dhe panumërtuar sipas elementëve të adresës.

Në nenin 9 të projektligjit shtohet parashikimi mbi mbulimin e shpenzimeve për tabelat e numërtimeve nga pronari i ndërtesës. Me qëllim arritjen e efikasitetit siç propozohet në bazë të këtij parashikimi ligjor rregullat për vendosjen e tabelës së numërtimit do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 10 të projektligjit shfuqizohet nenit 29 i ligjit, i cili parashikonte se: *“1. Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të bëjnë emërtimet e bulevardëve, të rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve ekzistuese të paemërtuara, brenda datës 31 dhjetor 2016. 2. Seksionet/zyrat e urbanistikës në njësitë e vetëqeverisjes vendore/njësitë administrative duhet të bëjnë adresimin numerik të brendshëm e të jashtëm të objekteve ekzistuese, brenda datës 31 dhjetor 2016. 3. Nëse njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk përmbushin detyrimet ligjore të përcaktuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, ato përmbushen nga prefekti i qarkut, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave”* Ky proces i parashikuar ligjërisht për t'u përmbushur brenda datës 31 dhjetor 2016, nuk është realizuar nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Sipas nenit 11 të projektligjit shfuqizohet nenit 32 i ligjit, i cili parashikonte se: *“Shkelja ose mosrespektimi i detyrimit ligjor, nga personat përgjegjës në seksionet dhe zyrat e urbanistikës të njësive të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuar në: a) pikën 2, të nenit 29, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë; b) nenin 31, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë”*.

Sipas kësaj dispozite, hiqet sanksioni administrativ ndaj personave përgjegjës në seksionet dhe zyrat e urbanistikës të njësive të vetëqeverisjes vendore, propozuar sipas këtij projektligji që të jenë strukturat përgjegjëse për planifikimin e territorit. Sanksionet do të aplikohen drejtpërdrejt ndaj kryetarit të bashkisë.

Sipas pikës 2 të nenit 29, parashikohej se seksionet/zyrat e urbanistikës në njësitë e vetëqeverisjes vendore/njësitë administrative duhet të bënin adresimin numerik të brendshëm e të jashtëm të objekteve ekzistuese, si një proces që rezultoi i përcaktuar që duhet të ishte përmbyllur brenda datës 31 dhjetor 2016. Të gjitha ndërtesat në zonën e qarkullimit civil në

territorin e bashkisë duhet të ishin pajisur me treguesit fizikë të brendshëm dhe të jashtëm, tabelat e numërtimit.

Sipas nenit 12 të projektligjit shfuqizohet nenit 33 i ligjit, i cili parashikonte se: *“Gjobat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 32, vendosen nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ankimohen në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi”*.

Dispozita e mëparshme sipas të cilës parashikohej vendosja e gjobës nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore për mospërmbylljen e procesit të adresimit numerik të brendshëm e të jashtëm të objekteve ekzistuese brenda datës 31 dhjetor 2016, si kundravajtje administrative është shfuqizuar. Në frymën e projektligjit sanksioni do të vendoset nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile ndaj kryetarit të bashkisë në të cilën do të rezultojnë pjesë të territorit publik të panumërtuara.

Në nenin 13 të projektligjit parashikohet miratimi i akteve nënligjore, respektivisht vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të pikës 4, të nenit 3 të këtij projekt ligji për algoritimin dhe strukturën e kodit unik të adresës, pikës 2, të nenit 4/3 të këtij projektligji për tarifatat për ofrimin e të dhënave të RKA-së dhe të paragrafit të 2, të nenit 9 për rregullat për vendosjen e tabelës së numërtimit.

Në nenin 14 të projektligjit parashikohet parashikohet hyrja në fuqi e tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 66, datë 16.05.2023 të Ministrit të Brendshëm *“Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar”*”.

Në Ministrinë e Brendshme, më datë 25.01.2023, është zhvilluar mbledhja e grupit ndërinstitucional të punës, e kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm, në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr. 208, datë 27.12.2002 *“Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Adresave dhe ndërlidhjen e Regjistrin Kombëtar të Adresave me bazat e të dhënave shtetërore”*, me pjesëmarrjen e anëtarëve të ngarkuar nga urdhri i Kryeministrit.

**IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
BUXHETORE**

Ky projektligj nuk ka efekte financiare.

PROPOZUESI

MINISTRI

Taulant Balla

